



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7790/21 datë:02.04.2021



Npi – 01/104 Datë: 20.04.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d), nenin 17 si dhe nenin 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Ligjit Nr.02/L-88 për trashëgiminë kulturore, Neni 1, pika 1.4; Nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë Npi – 01/205 datë: 14.07.2017; Nenin 8 të Rregullores së Punës së Kuvendit Npi-01/149 datë: 31.05.2019; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 20.04.2021 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK PROPOZIM-VENDIMIN PËR
DESTINIMIN E OBORRIT DHE SHKOLLËS NË FSHATIN LLANISHT**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 20.04.2021, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Vendimin për destinimin e Oborrit dhe Shkollës në fshatin Llanisht, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryesueses së Kuvendit, Zyrës së Kryetarit, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj